



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I QARKUT KORÇE



Nr. 44 Prot

Nr 111 Prot

15.01.2021

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë, 15.01.2021

**NDËRMJET:**

**KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË**  
përfaqësuar nga Kryetari Këshillit, **znj. ANA VERUSHI**

**DHE**

**KOMISIONIERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
përfaqësuar nga Komisionieri, **Z. ROBERT GAJDA**

Palët pjesëmarrëse që në vijim do të quhen “Palë nënshkruese” bien dakord dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi si më poshtë:

## **Neni 1**

### **Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qarkut Korçë, me qëllim përmirësimin e kushteve të komunitetit nëpërmjet garantimit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit, për marrjen pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në fushën e respektimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Të cilat synohen të arrihen duke:

- *Vlerësuar* rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.
- *U angazhuar* për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.
- *Konsideruar* si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë.
- *Afirmuar* vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshjeje.

## **Neni 2**

### **Objekti i Marrëveshjes**

Vënia në dispozicion nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë në favor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të një zyre në godinën ku ushtron veprimtarinë Këshilli, për të mundësuar ofrimin e shërbimit personave në nevojë duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nëpërmjet garantimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

## **Neni 3**

### **Baza Ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në dispozitat e Kushtetutës, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

## **Neni 4**

### **Detyrimet e Palëve**

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje palët marrin përsipër këto detyrime :

1. Këshilli i Qarkut Korçë vë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pa pagesë, një ambjent, zyrë, në godinën e Këshillit të Qarkut, që e vlerëson të përshtatshëm për ushtrimin normal të veprimtarisë të Zyrës Rajonale Korçë.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmbush të gjitha detyrimet në lidhje me shpenzimet konsumative mujore të ambjentit të vendosur në dispozicion (ujë dhe drita), në raport me numrin e përgjithshëm të ambjenteve që disponon Këshilli i Qarkut Korçë, bazuar mbi faturat mujore të cilat do ti përcillen nëpërmjet postës. Këshilli i Qarkut disponon 12 zyra. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të rimbursojë çdo muaj Këshillin e Qarkut me 1/12 e vlerës së faturës.

## **Neni 5**

### **Kushtet e Pagesës**

Çdo pagesë duhet bërë në përfundim të çdo muaji. PAGESA DO TE KRYHET KUNDREJT PARAQITJES SE DOKUMENTACIONIT JUSTIFIKUES (FATURES) TË RREGULLT, **brenda 30 ditëve** nga dita e paraqitjes së dokumentit. Monedha me të cilën do të bëhet pagesa është **Lek**, dhe kalimi i shumës sipas konsumit mujor do të kryhet nëpërmjet Thesarit me faturë arkëtimi.

## **Neni 6**

### **Komunikimi mes palëve**

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për realizimin e kësaj marrëveshjeje.
2. Palët vendosin me vullnetin dhe dëshirën e tyre që mënyra e shkëmbimit të informacionit reciprok të punëve midis tyre, të jetë në formë shkresore, ose në raste të veçanta nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar.

## **Neni 7**

### **Kohëzgjatja**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është pa afat.
2. Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
3. Nëse bien dakord, palët detyrohen midis tyre të njoftojnë me shkresë në rrugë zyrtare për përfundimin e marrëveshjes. Marrëveshja përfundon 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga pala tjetër.

**Neni 8**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do zgjidhet me diskutim dhe mirëkuptim midis palëve, në të kundërt do u nënshtrohet ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj prej palëve.

Kjo marrëveshje është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të nënshkruara nga të dy palët dhe me efekte ligjore të njëjta.

Pasi lexohet, ajo nënshkruhet me vullnet të lirë e të plotë nga të dyja palët, sot më datë 15.01.2021.

**KRYETARI I KËSHILLI I QARKUT KORÇË**



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**

